

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Tonka Berishaj, kryetare, Have Haliti dhe Fillim Skoro anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve N.C., D.A., A.G. dhe E.A., për shkak të veprës penale grabitja nga neni 329 par. 3 lidhur me par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit D.A., av. G.K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.89/2017, të datës 14.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, më datë 22.01.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.89/2017, i datës 14.12.2018, vërtetohet.

II. Për të akuzuarit N.C., A.G. dhe E.A., aktgjykimi mbetet i formës së prerë.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.89/2017, të datës 14.12.2018, i akuzuari D.A., është shpallur fajtor për veprën penale grabitja nga neni 329 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti dënim i zëvendësohet me dënim me burg duke ia llogaritur 20 € për çdo ditë burgim.

I akuzuari, D.A. është detyruar që të dëmtuarit D.M., t'ia kthejë të hollat e grabitura në shumë prej 970 €, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I akuzuari, D.A. është detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguan shumë prej 200 €, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 €, ndërsa në emër të kompensimit të viktimave të krimit, shumë prej 50 €. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër akuzuarve N.C., A.G. dhe E.A., në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së, është refuzuar aktakuza, sepse prokurori i shtetit në mungesë të provave ka hekur dorë nga aktakuza.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.A., av. G.K., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim relativisht më i butë.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA/L.nr.12/19 të datës 04.01.2019, ka propozuar që të refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.A., av. G.K., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezantuan i akuzuari D.A., ndërsa nuk prezantoi Prokurori i Apelit, av. G.K. dhe pala e dëmtuar D.M., edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën e mbajtjes së seancës, por me pëlqimin e të akuzuarit kjo gjykatë i caktoj av. R.K., sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. G.K., pas vlerësimit edhe të shkresave tjera në lëndë, gjeti se :

Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 të KPP-së, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit. Edhe pse gjendja faktike nuk kontestohet nga palët në procedurë, kjo gjykatë e vlerësoj aktgjykimin e ankimuar edhe mbi këtë bazë dhe konstaton se gjendja faktike është vërtetuar nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është mjaft i lartë edhe përkundër faktit se gjykata ka marrë për bazë disa rrethana lehtësuese, si gjendjen tejet të dobët ekonomike por është dashur ti vlerësoj edhe rrethanat tjera, si sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe faktin se i akuzuari është mbajtës i familjes pasi që të dy prindërit i ka të moshuar dhe të sëmur.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë rënduese gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i akuzuari është recidivist i veprave penale i dënuar për vepër penale të natyrës se njëjtë, nuk ka shfaqur pendim për veprën e kryer penale, ndërsa si rrethana lehtësuese ka gjetur gjendjen tejet të dobët ekonomike dhe moshën relativisht të re, se me dënimi i shqiptuar do të arrihet qëllimi dënimit i paraparë me nenin 41 të KPPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, të cilat rrethana në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë, por nuk e aprovon si rrethanë rënduese faktin se i akuzuari është recidivist i veprave penale të natyrës se njëjtë, sepse një gjë të tillë nuk e ka argumentuar me prova materiale, por pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është lartë, është i pabazuar, se veprat e tilla janë në rritje e sipër dhe janë bërë dukuri e shoqërisë ton, ashtu që dënimi i shqiptuar të akuzuarit, është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikojë edhe në personat tjerë që të mos kryejnë vepra penale, me të cilat dënime ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.626/18, të dt. 22.01.2019**

Procesmbajtësi,  
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit

Kryetarja e kolegjit  
1. Tonka Berishaj

2. Have Haliti

3. Fillim Skoro